

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E  
SHKENCËS  
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**  
**MATEMATIKË**  
**për klasën I**

**Shkup, viti 2021**

## TË DHËNA BAZË PËR PROGRAMIN MËSIMORË

Lënda mësimore	<b>Matematikë</b>
Lloji / kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	I (parë)
Konceptet / fushat në programin mësimorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Gjeometria</b></li> <li>• <b>Numrat dhe numërimi</b></li> <li>• <b>Operacionet me numrat</b></li> <li>• <b>Matjet</b></li> <li>• <b>Puna me të dhënat</b></li> </ul>
Numri i orëve	5 orë në javë / 180 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tabela qindëshe me numra, vargjet numerike, kartela me numra, kartela me fjalë dhe kuptime, shirita të zbrazët dhe vargje jo të numëruar nga letra, shirita rrëshqitës me numra, vargje me numra, numëratore, abakus (numëratore me toptha të drurit), vizatime, kartonë me simbole të shtypura (&lt; , &gt; , =), rrota me numra, grafiku me vlera vendore, pllaka matematikore.</li> <li>• Komplet 2D-forma dhe 3D-forma (plastike, metali, magnetike, kartoni), gjeotabela, pasqyra, format e letrës dhe kubet që lidhen ndërmjet veti.</li> <li>• Lojëra digjitale, shembull, <i>Domino</i>, Mos u hidhëro njeri ...</li> <li>• Gjësende të ndryshme për matje: gota, shishe plastike, bokall, enë të shënuar me litra, shirita nga letra dhe pëlhura, peshore, orë (orë nga rëra, orë analoge me shigjeta të cilat nxënësi mundet ti lëvizë, orë digjitale, monedha të vizatuara dhe bankënota nga 1, 2, 5 dhe 10 denarë, të holla të vërteta, çmime, etiketa.</li> <li>• Kuti, enë, lojëra, zhetonë dhe manipulative tjera (kapakë, makarona, thupra druri dhe të ngjashme.) të cilat do të ndihmojnë në numërim, laps, letër, vizore, gërshërë, ngjitës, materialë të llojeve të ndryshme për bërje të shembujve (leshra, <i>Ilastikë</i>, penj, Ngjitëse varëse, shtypka, shportë, plastelinë, farëra, fletëza, guralecë dhe të ngjashme.).</li> </ul>

<b>Normativi i kuadrit mësimor</b>	Punën edukativo arsimore në klasën e pare mund ta realizojë personi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• profesor / arsimtarë / mësues i grupit klasorë, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK;</li> <li>• profesor/edukatorë nga arsimi parashkollorë, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK;</li> <li>• pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK</li> </ul>
------------------------------------	--

## LIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet nga të mësuarit të theksuara në programin mësimorë udhëzojnë në përfitim të kompetencave vijuese të përfshira me fushën **Matematika dhe Shkencat natyrore** nga standardet nacionale:

<i>Nxënësi/nxënësja din dhe/ose mundet:</i>	
III-A.1	Të shfrytëzojë radhitje të operacioneve me numra të plotë, thyesa dhe numra decimal, duke përfshi edhe kllapa;
III-A.2	Të rrumbullakojë numra deri në shkallë të caktuar të precizitetit;
III-A.13	Të analizojë 3D-forma nëpërmjet rrjeteve dhe projeksioneve;
III-A.15	Të transformojë 2D-forma, duke kombinuar translacion, rotacion, simetri boshtore dhe ngjashmëri;
III-A.18	Ti shfrytëzojë njësitë matëse (gjatësi, masë, vëllim, syprinë dhe vëllim) në kontekst të ndryshëm;
III-A.23	Të interpretojë tabela, grafikë dhe diagrame, të krahasojë rezultate dhe të sjellë përfundime për saktësinë e hipotezës së shtruar
<i>Nxënësi /nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
III-B.1	Secili mundet të mësojë matematikë nëse mundohet mjaft për atë të mësuar;
III-B. 2	Njohuritë nga matematika gjejnë zbatim në shumë fusha të përditshmërisë;
III-B.3	Njohuritë nga matematika nevojiten për përvetësim të njohurive nga lëndët tjera dhe disiplinat tjera shkencore;
III-B.4	Mësimi i matematikës mund të jetë argëtues dhe interesant.

Programi mësimor përfshinë edhe kompetenca relevante nga fushat vijuese transversale të standardeve nacionale: **Njohuri digjitale**, Zhvillim personal dhe social, **Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Teknikë**, teknologji e sipërmarrësi.

<i>Nxënësi/nxënësja din dhe mundet:</i>	
IV-A.2	Të vlerësojë kur dhe në cilën mënyrë zgjidhet ndonjë detyrë /problem me shfrytëzim efektiv të IKT;
IV-A.5	Të caktojë se çfarë informata nevojiten, të gjejë, të zgjedhë dhe ndërmarrë të dhëna digjitale, informata dhe përmbajtje;
V-A.6	Të vejë qëllime për të mësuar dhe zhvillim personal dhe të punojë në tejkalim të sfidave të cilat paraqiten në rrugën e realizimit të tyre;
V-A.7	T'i shfrytëzojë përvojat personale që të lehtësojë të mësuarit dhe ta përshtatë sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.14	Të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të duhur, duke treguar empati dhe kuptim për të tjerët dhe ti tregojë brengat dhe nevojat e veta në mënyrë konstruktive ;
V-A.15	Të bashkëpunojë me të tjerë në realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke i krahasuar pikëpamjet e veta dhe nevojat me të tjerët dhe duke i marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	Të kërkojë informatë kthyesë dhe përkrahje për vete, por edhe të jep informatë konstruktive kthyesë dhe përkrahje në dobi të tjerëve ;
V-A.19	Të jep propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe ti parasheh pasojat me qëllim të nxjerrë konkluzione dhe të sjellë përfundime ose vendime racionale ;
VI-A.3	Ti formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, ti dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe me respektim të sjellët ndaj tyre edhe atëherë kur nuk pajtohet me ta;
VII-A.1	T'i lidhë njohuritë nga shkencat me zbatimet e tyre në teknikë dhe teknologji dhe me përditshmërinë.
<i>Nxënësi /nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	Mësimi digjital është e nevojshme për përditshmëri – e lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon për zgjerim të komunikimit, për kreativitet dhe inovacion, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
V-B.3	Të arriturat personale dhe mirëqenia në masë të madhe varen nga munda të cilin ai /ajo e je si dhe nga rezultatet të cilat i arrin;
V-B.4	Secili veprim që merret ka pasojë në vete atë /ate dhe /ose në rrethin e atij ose asaj;
V-B.7	Iniciativa, qëndrueshmëria, dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për realizim të detyrave, realizim të qëllimeve dhe tejkalim të sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	Interaksioni me të tjerët është dykahësh – siç ka të drejtë të kërkojë nga të tjerët të kërkojë /dhe ti mundësohet plotësimi i interesave personale dhe nevojave personale, ashtu ka përgjegjësi të u jep hapësirë tjerëve ti plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;

V-B.9

Kërkesa e informative kthese dhe pranimi i kritikave konstruktive qojnë kah përparimi personal në plan individual dhe social.

## REZULTATET NGA MËSIMI

<p>Tema: <b>GJEOMETRIA</b></p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: <b>20 (realizohen gjatë gjithë vitit)</b></p>	
<p><b>Rezultatet nga mësimi</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja do të aftësohet /të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>shfrytëzojë shprehje për kahe dhe largësi që ti përshkruaj lëvizjet e gjësendeve;</li> <li>shfrytëzon njohuritë për format e thjeshta 2D-dhe 3D-format dhe vijën e simetrisë në shembujt elementarë.</li> </ol>	
<b>Përmbajtjet (dhe konceptet)</b>	<b>Standardet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendndodhja, lëvizja dhe kahja (para, pas, deri, në, nën, mbi, lart, poshtë, në, brenda, jashtë, para, mbrapa, majtas nga, djathtas nga, (më)afër, (më)larg).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon pozitë ndërmjet objekteve në hapësirë.</li> <li>Vendos gjësende sipas kaheve të dhëna për vend ndodhi.</li> <li>Realizon lëvizje në hapësirës sipas kaheve të marra.</li> <li>Planifikon (paramendon) kahe të lëvizjeve në hapësirë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>2D - forma  (rrethi, trekëndëshi, drejtkëndëshi, katrori, vijat e drejta, vijat e lakuara).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon vija të drejta nga vija të thyera (e hapur dhe e mbyllur).</li> <li>Emërton 2D-forma dhe thekson ngjashmëri dhe dallime ndërmjet tyre.</li> <li>Përshkruan 2D-forma.</li> <li>Grupon 2D-forma edhe sipas numrit të faqeve, me vija të drejta dhe të thyera.</li> <li>Vizaton dhe formon 2D- forma .</li> <li>Punon modele nga format e dhëna 2D.</li> <li>Zbërthen 2D-forma në forma tjera 2D- dhe nga ekzistueset 2D - forma organizon forma të reja.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>3D - forma  (kubi, kuadri, cilindri, koni, topi).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njeh dhe emërton 3D-forma.</li> <li>Përshkruan dhe krahason 3D-forma.</li> <li>Krahason dy 2D dhe dy 3D-forma.</li> <li>Grupon 3D -forma sipas numrit të sipërfaqeve dhe sipas sipërfaqeve të rrafshëta dhe jo të rrafshëta.</li> <li>Punon modele prej 3D-formave nga skema të gatshme.</li> <li>Thekson ngjashmëri dhe dallime ndërmjet 3D-formave.</li> <li>Identifikon 2D-forma në 3D-forma.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vija e simetrisë (përputhshmëria, vija e simetrisë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njeh vijën e simetrisë te 2D-format dhe vizatime të objekteve.</li> </ul>

## Shembuj dhe aktivitete

- Nxënësit lëvizin në rretë të vizatuar të dyshemesë, sipas instruksioneve të marra nga të tjerët që të arrijnë te qëllimi i caktuar.
- Arsimtari i tregon në mënyrë vizuale raportet ndërmjet objekteve (para/pas; lart / posht; majtas nga /djathtas nga..).
- Arsimtari nëpërmjet paraqitjes vizuale sqaron drejtëz dhe lakore, vijë (të hapur dhe të mbyllur ).
- Arsimtari shfrytëzon përmbledhje prej 2D-forma që ti përshkruajë.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, përshkruajnë 2D-forma të fituara nga arsimtari.
- Nxënësit, punojnë në çifte, punojnë modele të 2D-formave në letër ose gjeotabelë dhe i sqarojnë njëri tjetrit.
- Nxënësi emërton forma të cilat përgjigjen numrit të faqeve, në vijë të drejtë dhe të shtrembët, të treguara nga ana e arsimtarit ose nga shoku i tij (nxënës).
- Arsimtari tregon model /model të përpiluar nga 2D -forma dhe diskuton me nxënës për 2D-format nga të cilat është përbërë modeli.
- Nxënësit vizatojnë 2D-forma me ndihmën e vizores përkatëse (sipas kaheve të dhëna nga arsimtari).
- Nxënësit, në çifte, diskutojnë për ndarjen e 2D-formave në tjera 2D-forma (shembull, katrorë ndajnë në dy trekëndësha dhe ngjashëm.) dhe nga ekzistueset 2D-forma sit ë organizojnë të reja (shembull, nga katror formojnë drejtkëndësh e tj.).
- Nxënësit në grupe me ndihmën e llastikave, leshi e të ngjashme formojnë 2D-forma ose tregojnë 2D-forma me ndihmën e duarve, pjesëve të trupit (sipas rekomandimeve të dhëna nga arsimtari).
- Nxënësit individualisht zgjedhin nga një 3D-formë dhe të njëjtën e përshkruajnë sipas shembullit të dhënë nga arsimtari.
- Arsimtari kërkon nga Nxënësit ta caktojnë pozitën ndërmjet 3D-formave të ndryshme / gjësend nga hapësira (shembull, kubi është në tavolinë, topi është nën tavolinë).
- Nxënësit në grupe bëjnë modele 3D-forma me gypa plastike, të lidhur me plasteline ose glinë.
- Nxënësit shfrytëzojnë fleta mësimore interaktive dhe lojëra (*Wordwall, Liveworksheets, Jigsaw planet*).
- Nxënësit në grupe të vogla diskutojnë dhe i klasifikojnë 3D - format sipas numrit të sipërfaqeve, sipas sipërfaqeve të rrafshëta dhe jo të rrafshëta.
- Nxënësit, në çifte, me shfrytëzim të fotografive të prera në gjysmë e tregojnë vijën e simetrisë.

Tema: **NUMRAT DHE NUMËRIMI**

Numri i përgjithshëm i orëve: **50**

## Rezultatet e mësimi

Nxënësi /Nxënësja do të jetë i aftë/e aftë të:

1. Numëroj gjësende, lexojë dhe shkruaj numra nga 0 deri 20;
2. E shfrytëzojnë njohurinë të krahasojë dy numra dhe grup të gjësendeve deri 30;

3. grupon numra çift dhe tek deri 20.	
Përmbajtje (dhe konceptet)	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Numrat deri 30 (numri, sasia, shifra).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numëron me radhë (prej 1 deri 100, mbrapsht prej 20 deri 0).</li> <li>Numëron gjësende deri 20 dhe e lidhë sasinë e gjësendeve me me numrin përkatës.</li> <li>Numëron nga dhjetë prej 0 deri 100.</li> <li>Bën vlerësim të arsyeshëm për numrin e disa gjësendeve që mund të vërtetohet me numrin deri 30.</li> <li>Lexon dhe shkruan shifra prej 0 deri 9.</li> <li>Shënon numra deri 20.</li> <li>Emërton çifte numrash shuma e të cilëve është 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Krahasim i numrave deri 30 (më i madh, më i vogël, më tepër, më pak).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I shfrytëzon kuptimet <b>më i madh</b> ose <b>më i vogël</b> që të krahasojë dy numra deri 30 dhe tregon numër që ndodhet ndërmjet tyre.</li> <li>I shfrytëzon kuptimet <b>më tepër</b> ose <b>më pak</b> për krahasim të grupeve të gjësendeve deri 30. Radhit numra deri më së paku 20 në vargun e numrave.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Numrat çift dhe tek (çift, tek),</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numëron nga 2 deri 20 dhe nga 10 deri 100.</li> <li>Dallon numrat çift dhe tek deri 20 (shembull, 2, 4, 6... ose 1, 3, 5...).</li> <li>Bën dallim ndërmjet numrave çift dhe tek deri 20.</li> <li>Thekson numër për dy më të madh ose për dy më të vogël nga ndonjë numër deri 20.</li> </ul>
<b>Shembuj të aktiviteteve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Arsimtari tregon një nga një kartelat me numra, ndërsa nxënësit vendosin sasi përkatëse të gjësendeve në tavolinë.</li> <li>Arsimtari secilit nxënës i jep kartelë me numër më të vogël se 20, ndërsa nxënësit në çifte e vazhdojnë vargun, me gojë ose me shkrim.</li> <li>Arsimtari shfrytëzon, shembull, varëse dhe 10 kapëse që ti tregojë dhe sqarojë çiftet e numrave shuma e të cilëve është, për shembull, 10.</li> <li>Nxënësit në grupe të vogla luajnë lojëra me paketim të zbrazët nga kartoni për 10 vezë, zhetonë ose kapakë dhe i zbulojnë çiftet e numrave shuma e të cilëve është, për shembull, 7.</li> <li>Nxënësit në çifte tërheqin disa karta me numra, e pastaj e theksojnë numrin që është për 1 më i madh ose më i vogël nga ai numri i tërhequr në kartë me numër të shënuar.</li> <li>Secili nxënës me gisht shënon shifra prej 0 deri 9, në ajër, në miell, rërë, bore e të ngjashme.</li> <li>Nxënësit shfrytëzojnë plastelina, Pejë, toptha, kapake, farëra, gypa, leshra që të modelojnë numra.</li> </ul>	



- Nxënësit në çifte, identifikojnë dhe numërojnë objekte në oborr të shkollës.
- Nxënësit luajnë në çifte: njëri shënon numër në shpinë të shokut, e tjetri e qëllon cili numër është shënuar.
- Arsimtari bën përzjerjen e kartelave me numra, nxënësit i mbledhin kartelat dhe i radhitin numrat nga 1 deri 10, deri 20.
  - Nxënësit nga valixhja nxjerrin kartelë me numra dhe qëllojnë se a është numri çift ose tek.
  - Nxënësit të ndarë në çifte, me shfrytëzim të tabelës 100 numërojnë dhjetëshet deri 100.
  - Nxënësit, të ndarë në çifte, me shfrytëzim të tabelës 100 përcaktojnë vlera për 1 më shumë, për 1 më pak, për 10 më shumë, për 10 më pak.
  - Nxënësit në çifte, bëjnë vargje numerike me renditje të makaronave të ndryshme me ngjyrë dhe në disa mënyra të ndryshme.
  - Nxënësit veç e veç ngjyrosin modele të 2D-formave në varg sipas ndonjë rregulle.
  - Nxënësit në çifte, shfrytëzojnë gjësende të vogla (shembull: kapakë, makarona të ngjyrosur) që të formojnë varg „të zmadhuar për 2“.
  - Arsimtari e fillon lojën për të qëlluar: nxënësit duhet të japin vlerësim sa gjësende ka në kavanozin e tejdukshëm, e pastaj provojnë me numërim të gjësendeve.
  - Arsimtari u jep nxënësve situatë problematike, për shembull, u jep kartela me numra dhe detyra. Shembull: „Secili le të më tregoj numër që është më i madh për 6 dhe më vogël se 9“; „Secili le të më tregoj numër që është më i madh për 9 dhe më i vogël se 13“ dhe të ngjashme.

Tema: **OPERACIONET ME NUMRAT**

Numri i përgjithshëm i orëve: **80**

### Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të aftësohet të:

1. Mbledhë dhe zbret numra deri 20;
2. Dyfishon dhe përgjysmon numra deri 10.

### Përmbajtje (dhe koncepte)

- Mbledhja dhe zbritja deri 10 (Mbledhja, zbritja, herësi, numri njëshifrorë).

### Standardet e vlerësimit

- I tregon të gjitha çiftet e numrave shuma e të cilëve është 10 dhe atë e lidhë me mbledhjen.
- Mbledhë me numërim para dhe me kombinim të dy sasive.
- Zbret me numërim mbrapa dhe me zbritje të një sasive nga tjetra.
- Mbledhë mbledhës të njëjta deri  $5 + 5$ .
- Thekson shembuj të mbledhjes dhe zbritjes nga situatë të përditshmërisë.
- Mbledhë tre numra njëshifrorë, ku shuma e dy prej tyre është 10.
- Sqaron se ndryshimi i radhitjes së mbledhësve nuk e ndryshon shumën.

<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledhja dhe zbritja deri 20 (Mbledhja, zbritja, + , – dhe =).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I ndërron shenjat + , – dhe =.</li> <li>Emërton numër që është për 1 ose për 10 më i madh ose më i vogël nga cilido numër i dhënë prej 0 deri 30.</li> <li>Lidh numërimin para dhe mbrapa me nga dhjetë për gjetje të numrave të cilët janë për 10 më të mëdhenj/më të vegjël nga ndonjë numër (deri 100).</li> <li>I shfrytëzon shenjat + , – dhe = në gjykimet matematikore të cilat I përkasin mbledhjes ose zbritjes.</li> <li>E kupton përdorimin e shenjës <math>\square</math> në vend të numrit të panjohur gjatë mbledhjes dhe zbritjes.</li> <li>I zbërthen numrat dyshifrorë deri 30 në dhjetëshe dhe njëshe dhe anasjelltas.</li> <li>Shfrytëzon strategji të ndryshme për mbledhje të çifteve të numrave deri 20.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Dyfishim dhe përgjysmim të numrave deri 10.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dyfishon cilindo numër njëshifrorë.</li> <li>Gjen gjysmën e numrit çift të gjësendeve deri 10.</li> <li>Përgjysmon forma me thyerje.</li> <li>Numëron numra dhe gjësende të cilat mund të përgjysmohen.</li> </ul>

### Shembuj dhe aktivitete

- Nxënësit në mënyrë individuale përgjigjen në pyetje, si për shembull: „nëse fillojmë nga 7 dhe numërojmë 5 para, cili numër do të fitohet?“.
- Arsimtari me numërim nga mbrapa në vargun numerik ose tabelë qindëshe e sqaron zbritjen.
- Nxënësit nëpërmjet „pjesë – pjesë – tërë“ mbledhin dhe zbresin numra, e theksojnë lidhjen e kundërt të mbledhjes dhe zbritjes.
- Nxënësit, të ndarë në çifte, gjuajnë dy kube në rrotën e cila sjellet me numra dhe njehsojnë shumë të numrave .
- Nxënësit shfrytëzojnë lista mësimore interactive dhe lojra (Wordwall, Liveworksheets, Jigsaw planet).
- Nxënësit, të ndarë në çifte, zbresin numër nga numra të ndryshëm fillestarë
- Arsimtari nxit diskutim me gjithë paralelen: „Si erdhët deri te përgjigja kur zbritët një numër nga tjetri?“.
- Me shfrytëzim të peshores me dy tas dhe numër të njejtë ose të ndryshëm gjësendesh, arsimtari shpjegon domethënien e shenjës „ = “.
- Nxënësit, të ndarë në çifte, zbulojnë numrin që duhet të qëndrojë në  $\square$  që të zgjidhin detyra, si për shembull  $6 + \square = 10$ ;  $10 - \square = 6$ .
- Nxënësit, shfrytëzojnë duar dhe këmbë që të numërojnë nga dy, e gishtat që të numërojnë nga 10.
- Arsimtari shfrytëzon mjete të ndryshme për punë (shkopinj, kartela, shigjeta me numra..) që ta sqarojë vlerën mesatare të numrat dyshifrorë.

- Nxënësit, shfrytëzim të manipulativëve zbërthejnë numra dyshifrorë në dhjetëshe e njëshe.

- Nxënësit, të ndarë në çifte, shfrytëzojnë „makineri funksionale“ që ta zbulojnë lidhjen ndërmjet numrave (për shembull, ta shënojnë njërin mbledhës ose shumën).
- Arsimtari nëpërmjet shembujve sqaron përgjysmim të numrit çift të gjësendeve, forma, si dhe ndamje të gjësendeve numri i të cilave është më i vogël se 10.
- Arsimtari shfrytëzon sasi të vogla gjësendesh dhe i ndanë në pjesë të njejta (përgjysmë), tregon edhe shembuj ku gjatë përgjysmimit ka mbetje.

Tema: **MATJET**

Numri i përgjithshëm i orëve: **20 (realizohen gjatë tërë vitit)**

### Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të aftësohet të:

1. Njehsojë se si të paguhet saktë shuma deri 20 denar me shfrytëzim të monedhave më të vogla bankënota deri 10 denarë;
2. Vlerëson dhe mate gjatësi, masë dhe vëllim me shfrytëzim të njësive jo standarde të zakonshme;
3. Lexon kohën (orë e minuta) dhe t'i radhitë kohërat vendimtare në ditë, ditët në javë dhe muaj të vitit.

#### Përmbajtjet (dhe kuptimet)

#### Standardet për vlerësim

- |   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paratë<br/><br/>(monedhat:1, 2, 5 dhe 10 denarë dhe banknotat prej 10 denarë).</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh dhe emërton monedha më të vogla.</li> <li>• Grupon monedha sipas vlerës.</li> <li>• Përcakton shumë të saktë të hollash me shtim ose heqje të monedhave.</li> <li>• Thekson disa mënyra me të cilat mund të paguhet shumë e caktuar (për shembull, 17 denarë).</li> </ul>  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjatësia, masa, vëllimi</li> <li>• (Gjatësia, masa, vëllimi, shputa dorës, bërryli, shputa e këmbës, hapat, gjatë, shkurtë, më e gjatë, më e shkurtë, rëndë, lehtë, më rëndë, më lehtë, më shumë, më pak...).</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson gjatësinë, masë dhe vëllim me njësi jo standarde.</li> <li>• Numëron njësi jo standarde për gjatësi, masë dhe vëllim.</li> <li>• Shfrytëzon njësi të zakonshme jo standarde për gjatësi, masë dhe vëllim gjatë matjes.</li> <li>• Krahason gjatësi, masë dhe vëllim dhe i thekson rezultatet nga krahasimi.</li> </ul> |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koha<br/><br/>(minuta, orë, ditë, javë, muaj de vite, shkurt).</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon kohën në orë dhe minuta.</li> <li>• I numëron kohërat vendimtare të ditës (mëngjesin, mesditën, mbrëmjen).</li> <li>• Thekson çka bën në mëngjes, mesditë dhe mbrëmje.</li> <li>• I radhit ditët e javës, muajve në vit.</li> <li>• Vlerëson sa kohë i nevojitet për aktivitete të caktuara.</li> </ul>                   |

## Shembuj dhe aktivitete

- Nxënësit nga ena i nxjerrin monedhat dhe i grupojnë sipas vlerës.
- Arsimtari u sqaron nxënësve se si mundet me shfrytëzim të monedhave të ndryshme të fitohet shuma e njëjte (për shembull, 12 denarë).
- Nxënësit (të ndarë në grupe) luajnë rol të shitësit dhe blerësit me shfrytëzim të parave.
- Nxënësit (në çifte) masin gjatësi, si për shembull: gomës, fletore dhe bankë shkollore..., me gishta dhe pëllëmbë.
- Nxënësit vlerësojnë ku ka më shumë ujë: në enë të mëdha, të vogla, enë të tejdukshme të gjëra dhe të ngushta dhe e masin vëllimin me gotë plastike të vogël.
- Nxënësit vlerësojnë dhe krahasojnë se cilat nga dy gjësendet është më I rëndë ose më I lehtë, për shembull, dy protokolle me madhësi të ndryshme, kubi nga plastika ose kartoni, luga e drurit apo metalit, balona dhe topi.
- Nxënësit vizatojnë atë se çka bëjnë në mëngjes, mesditë dhe në mbrëmje.
- Nxënësit në çifte numërojnë sa here kërcejnë për kohë prej një minute dhe i krahasojnë rezultatet ndërmjet veti.
- Nxënësit (në grupe) zgjidhin situatë problematike: radhitin ngjarje të njohura në ditë, javë ose në tregime.
- Arsimtari u tregon nxënësve ku gjinden shigjetat e orës kur është ora 7, ora 12, ora 19, ora 20.
- Nxënësit shikojnë orë në kompjuter që ta lexojnë kohën në orë e minuta.
- Arsimtari parashtron pyetje në të cilat nxënësit përgjigjen, si për shembull: „Sot është e mërkurë, cila ditë do të jetë pas tre ditëve ?; Sot është e hënë, cila ditë do të jetë pas pesë ditësh?“.
- Nxënësit në grupe, krahasojnë lexim të kohës në orë analoge dhe digjitale.
- Nxënësit në grupe, radhitin perioda kohore në tabela (zgjat ma pak se një orë, zgjat saktë një orë, zgjat më shumë se një orë).

Tema: **PUNA ME TË DHENA**

Numri i përgjithshëm i orëve: **10 (realizohen gjatë tërë vitit)**

### Rezultatet e mësimin

Nxënësit / Nxënëset do të aftësohen të:

1. Shfrytëzojë tabela dhe diagrame për të arrite përfundime;
2. Radhit, tregon dhe lexon të dhëna në tabelë dhe diagrame.

### Përmbajtje (dhe konceptet)

- Mbledhë, tregon, interpreton dhe lexon të dhëna

### Standardet e vlerësimit

- Mbledhë dhe shënon të dhëna në lista dhe tabela.
- Rregullon të dhëna në tabelë.
- Shfrytëzon diagram të Venit dhe Kerolit dhe për të dhënat e gjësende të grupuara

(të dhëna, tabela, piktograme, diagram shtyllorë, diagram të Venit, Kerollit<sup>1</sup>).

- Lexon dhe sqaron të dhëna të paraqitur me tabela, piktogram, diagram të Venit e Kerollit dhe diagram të thjeshtë shtyllor.
- Sqaron kriterin sipas të cilit janë grupuar gjësendet në diagramin e Venit dhe Kerollit.
- Sqaron në cilën mënyrë I ka paraqitur /të dhënat (për shembull, me vizatim, vendosje të gjësendeve ose fotografi në tabelë të vizatuar).
- Propozon kriteret të ndryshme për grupim të gjësendeve të njëjta.
- Nxjerrë përfundime nga rezultatet të vendosur në lista, tabela dhe diagrame.

### Shembuj për aktivitete

- Nxënësit në grupe formojnë shtylla me kube, duke I renditur njëzënjë përreth tjetrës, e pastaj i krahasojnë cila është më e ulët /më e lartë,.
- Nxënësit në grupe, klasifikojnë gjësende sipas vetive të përbashkëta, duke i vendosur në rreth gjegjës (shembull, rreth) – në rrethin e parë ose në rrethin e dytë, e pas mund të zbulojnë se disa gjësende i takojnë edhe rrethit të parë dhe të dytë.
- Në oborr të shkollës nxënësit numërojnë bimë, e në tabelën e vizatuar nga arsimtari në flipçart shënojnë të dhëna, duke i grumbulluar sipas llojit të bimëve.
- Nxënësit grumbullojnë dhe rregullojnë të dhëna (shembull, „Ushqimi im i preferuar“, „Lënda ime e preferuar“, „ Loja ime e preferuar“ e tjera.), e të dhënat paraqiten me vizatim, vendosje të gjësendeve ose ngjitje të fotografive në tabelë të vizatuar paraprakisht.
- Arsimtari vizaton rende dhe kolona në oborrin e shkollës, nxënësit renditen sipas kriterit të dhënë: ngjyra e flokëve, veshja
- Nxënësit lexojnë të dhëna nga tabela ku janë paraqitur, shembull, të dhëna për ngjyrën e syve të nxënësve në një paralele , numri i vajzave dhe djemve në paralele dhe ato të dhëna i krahasojnë me gjendjen në klasën e tyre.
- Nxënësit të ndarë në çifte mbledhin të dhëna për lëndët në klasë (karrige, banka, fletore, libra dhe lapsa) dhe i paraqesin në tabelë.
- Nxënësit grupojnë numra (më të mëdhenj se 4 deri te numri 10, më të vegjël se 4).
- Arsimtari përgatit shembuj vizual me të dhëna, shembull, mjete transporti nga rrethina (vizatimi), e nxënësit i grupojnë në kolona dhe i krahasojnë që të caktojnë cilat janë më pak e cilat më shumë.
- Nxënësit në çifte, i shënojnë numrat çift dhe tek deri 20 në një tabelë.

<sup>1</sup> Nuk pritët që nxënësit ti mësojnë kuptimet, por të dijnë ti shfrytëzojnë nëpërmjet aktiviteteve konkrete.

- Nxënësit të ndarë në grupe të vogla, në piktogram paraqesin cilat fryte të pemëve janë më të dëshiruara në grupin e tyre.
- Nxënësit në grupe, luajnë me 3D forma dhe i grupojnë në diagram të Venit, sipas kritereve të ndryshme.
- Nxënësit në grupe, mbledhin të dhëna për desertin më të preferuar dhe të dhënat i paraqesin në tabela dhe diagram shtyllor

## INKLUZIVITETI, BARAZIA GJINORE /SENZITIVITETI, INTERKULTURA DHE NDERMJETESIA

Arsimtari siguron inkluzivitet duke i përfshirë gjithë nxënësit në gjitha aktivitetet gjatë orës. Mundëson secili fëmijë të jetë kognitiv dhe i angazhuar emocionalisht duke shfrytëzuar qasje adekuate (individualizim, diferencim, punë ekipore, përkrahje të ndërsjellët). Gjatë punës me nxënës me të me ta zbaton plan arsimorë individual (me rezultate të përshtatura nga të mësuarit dhe standard të vlerësimit) dhe gjithnjë kur është e mundur shfrytëzon përkrahje plotësuese nga individ tjerë (asistent arsimor individual, mediatorë arsimorë, tutorë voluntarë dhe profesionistë nga shkollat me qendër të resurseve). Rregullisht i përcjellë të gjithë nxënësit, veçanërisht ata të grupeve të nevojave, që të mundet me kohë ti identifikojë vështirësitë në mësim, ti nxitë dhe përkrahë në arritjen e rezultateve nga të mësuarit.

Gjatë realizimit të aktiviteteve arsimtari njëlloj duhet ti trajtojë vajzat dhe djemtë. Gjatë formimit të grupeve për punë tenton të sigurojë balancim ndaj poleve. Gjatë zgjedhjes së materialeve plotësuese në mësim shfrytëzon ilustrime dhe shembuj të cilat janë nga ploi dhe etnikumet /sensitive kulturore dhe nxitin barazi gjinore, promovojnë interkulturalizmin (shembull, në detyrat tekstuale shfrytëzohen emra karakteristike për pjesëtarët të etnikumeve të ndryshme dhe bëhet llogari në që fytyrat e meshkujve dhe femrave të mos ndërlidhen me role stereotipa gjinore).

Kur mundet arsimtari shfrytëzon integrim të temave / përmbajtjeve /kuptimet gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimin. Integrimi mundëson nxënësit ti kyqin perspektivat e lëndëve tjera mësimore në atë që e mësojnë në këtë lëndë mësimore dhe ti lidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

## VLERESIMI I TE ARRITURAVE TE NXENESVE

Qe të mundet të nxënësi ti arrijnë standardet e pritura për vlerësim, arsimtari i përcjellë në kontinuitet aktivitetet e nxënësve për kohën e të mësuarit dhe mbledhë informata për përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrje në aktivitet nxënësit marrin informatë kthyesë në të cilën tregohet niveli i suksesshmërisë në realizimi n e aktivitetit / detyrës dhe jepen kahet për përmirësim (vlerësimi formativ). Për atë qëllim arsimtari i përcjellë dhe noton:

- Përgjigjet me gojë në pyetje të parashtruara nga arsimtari ose nga pjesëmarrësit;
- Realizimi praktik (shembull, grupimi 2D-forma me karakteristika të ndryshme, zgjidhja e detyrave matematikore, lojëra digjitale);
- punimet (modelet);
- përgjigjet / zgjidhjet të dhëna në fleta pune, listat punuese etj.;
- detyra shtëpie.

Me shfrytëzim të teknikave të ndryshme dhe instrumenteve për vlerësim (shembull, çek lista, cek lista me shkallë vlerësimi etj.) arsimtari nxjerrë note sumative në formë përshkuese në standardet e arritur për vlerësim. Në fund të tremujorit të parë, gjysmëvjetorin e parë dhe tremujorin e tretë nxënësit fitojnë note mikrosumative përshkuese e në fund të vitit shkollorë note përshkuese sumative përfundimtare.

<b>Fillimi i implementimit të programit arsimorë</b>	Viti shkollorë 2021/2022
<b>Institucioni/ përfaqësues i programit</b>	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
<b>Sipas nenit 30, alinesë 3 nga Ligji për arsim fillorë („Gazeta Zyrtare e R. M.V.“ nr. 161/19 dhe 229/20) Ministri i Arsimit dhe e Shkencës e miratoi programin mësimorë nga lënda <i>Matematikë për klasën I</i></b>	nr. 12-6200/4 9.4.2021  Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Milla Carovska, n.p.